



BASHKIA E TIRANËS KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 17, datë 06.03.2015

Për

“NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 8, DT. 12.10.2011 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË APARATIT TË BASHKISË SË TIRANËS (I NDRYSHUAR)”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32 shkronja “ç”, nenit 33, pika 6 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, (i ndryshuar); nenit 128, i ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; neni 4 i ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 për “Inspektimin e ndërtimit” (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr.8, datë 12.10.2011 për “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në strukturën organizative të Bashkisë së Tiranës miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 8, dt. 12.10.2011 për “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar), sipas organogramës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të paraqesë për miratim në Këshill Bashkiak shtesat dhe ndryshimet përkatëse në rregulloren e Bashkisë së Tiranës miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.14, datë 02.05.2012 për “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës”.
3. Efektet financiare për paga dhe sigurime shoqërore do të përballohen nga buxheti i vitit 2015 për strukturën organizative të Bashkisë Tiranë
4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K RYETARI

ALDRIN DALIPI